



ASOCIATION
“LOYOLA-GYMNASIUM”

POLITIKA PËR
MBROJTJEN E FËMIJËVE

Prizren, Shtator 2024

Përmbajtja

1.1 Qëndrimi jonë - parimet edukative.....	3
1.2 Politika jonë është e bazuar në:	3
1.3 Qëllimi (Fushëveprimi)	3
2. Hyrje	4
2.1 Qëndrimi ynë ndaj Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve	4
3. Qëllimet dhe synimet e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.....	5
3.1 Përkufizimi i Mbrojtjes	5
3.2 Synimi i politikës.....	5
4. Çfarë është abuzimi i fëmijëve? – përkufizimet dhe terminologjia	6
4.1 Nga rrjedh abuzimi i fëmijëve?	6
4.2 Përkufizimet e katër llojeve kryesore të abuzimit të fëmijëve	6
4.2.1 Abuzimi fizik	6
4.2.2 Abuzimi seksual	6
4.2.3 Neglizhimi.....	7
4.2.4 Abuzimi emocional.....	7
4.3 Konsideratat specifike	7
4.3.1 Abuzimi fëmijë-fëmijë	7
4.3.2 Deklarimet e historive të abuzimit.....	8
4.4 Shkelja e privatësisë së fëmijëve.....	8
5. Palët e interesuara	9
5.1 Mesazhet kyçe për palët e interesuara.....	9
6. Implikimet për organizatën: Ajo që ne bëjmë - pjesët kyçe të kësaj politike	10
6.1 Vetëdijësimi	11
6.2 Parandalimi	11
6.3 Raportimi.....	12
6.3.1 Kush duhet të raportojë?	12
6.3.2 Kujt mund t'i raportojë?.....	13
6.3.3 Pika Fokale	14
6.4 Reagimi.....	14
7. Vlerësimi i riskut.....	17
8. Dispozita të tjera	18

1. Pozita e Asociacionit Loyola – Gymnasium

1.1 Qëndrimi jonë - parimet edukative

Loyola-Gymnasium është një vend ku nxënësit dhe të rinjët mësojnë dhe kuptojnë historinë dhe rrënjët e njerëzimit, fitojnë diturinë dhe shprehinë e krijimit të ideve, mësojnë të shijojnë arritjet dhe të ballafaqohen me humbjet dhe zhvillojnë mjetet e domosdoshme për ndërtimin e një të ardhme të përbashkët. Në këtë mënyrë shkolla jonë përpiqet të inkurajojë nxënësit e saj me kompetencë, vetëdije dhe përkushtim të shtuar.

Në të njëjtën kohë ne përpiqemi të ofrojmë edukim për demokraci që është elementi kyç për zhvillimin demokratik të një shteti.

Për më tepër, ne e shohim veten si një element në sistemin e edukimit të Kosovës prandaj, në bazë të marrëveshjes mbi themelimin e shkollës, ne i respektojmë ligjet dhe udhëzimet e Kosovës.

Për t'i arritur këto qëllime Loyola-Gymnasium duhet të jetë një vend i sigurtë ku secili është i vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrat e tij.

1.2 Politika jonë është e bazuar në:

- Misionin dhe vlerat e ALG-së duke përfshirë të gjitha projektet dhe programet tona;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve dhe kornizën ligjore të Republikës së Kosovës;
- Përvojat dhe njohuritë e stafit të ALG-së (mësimdhënësit, edukatorët, administrata, bordi dhe stafi teknik), fëmijëve (Parlamenti i Nxënësve dhe Parlamenti i Konviktit), prindërve, komunitetit dhe palëve të tjera kompetente;
- Standardet për mbrojtjen e fëmijëve të përcaktuara nga Koalicioni Për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë dhe vet ALG-ja .

1.3 Qëllimi (Fushëveprimi)

Konsiderata jonë parësore është interesi më i mirë i fëmijës. Secili fëmijë ka të drejtë të zhvillojë potencialin e tij apo të saj të plotë, në një edukim kualitativ, me pjesëmarrje të barabartë dhe në mosdiskriminim. Secili ka përgjegjësinë t'i mbrojtë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, braktisjes, shfrytëzimit dhe diskriminimit. Kjo politikë i kushton vëmendje të veçantë mekanizmave të brendshëm për parandalimin dhe reagimin ndaj abuzimit të fëmijëve brenda fushëveprimit të ALG-së.

2. Hyrje

Ky dokument është rezultat i një procesi konsultimi me grupet relevante. Dokumenti i politikës është i detyrueshëm për të gjithë stafin dhe bashkëpunëtorët e ALG-së (afatshkurtër dhe afatgjatë). Bazuar në këtë politikë, ALG-ja do të zbatojë dhe komunikojë strukturat e qarta të raportimit dhe reagimit, si dhe planet e qëndrueshme të menaxhimit të krizave pasi që ne angazhohemi për të ndërtuar qasjen tonë për të sjellë në jetë mbrojtjen e fëmijëve në ALG. Duke u angazhuar me parandalimin e abuzimit dhe si reagojmë ndaj abuzimit të dyshuar, kjo politikë synon të veprojë si një udhërrëfyes për të menaxhuar aktivitetet e përditshme me fëmijët.

Referenca të shumta që lidhen me fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe mjetet mbështetëse e plotësojnë këtë politikë. Prandaj, vëmendje e veçantë i është kushtuar, për shembull, punësimit të stafit të ri, përfshirjes së mediave sociale dhe mjeteve të reja të raportimit dhe komunikimit. Një plan vjetor i veprimit që reflekton masat mbrojtëse brenda personave të përfshirë (ref. 1.2) siguron që sistemi të zbatohet siç duhet.

Ne jemi të vetëdijshëm se rreziku i dëmtimit të integritetit të fëmijëve është shumë real dhe për këtë arsye ne jemi të përkushtuar që të promovojmë gjerësisht Politikën tonë të Mbrojtjes së Fëmijëve, jo vetëm brenda, por edhe me organizatat partnere që përfaqësojnë fëmijët dhe me të cilët veprojmë. Në rast abuzimi ose dyshimeve për abuzim, parimi ynë themelor kërkon një reagim të menjëhershëm dhe profesional në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.1 Qëndrimi ynë ndaj Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve

Ne besojmë fuqimisht se përdorimi sistematik i kësaj Politike është mënyra më e mirë për të siguruar që të gjithë fëmijët të marrin mbrojtjen e nevojshme për të cilën kanë të drejtë.

Çdo fëmijë mund të bëhet viktimë e abuzimit dhe shfrytëzimit. Disa vajza dhe djem mund të jenë më të ndjeshëm ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit, për shkak të formave të ndryshme të diskriminimit dhe marginalizimit në lidhje me statusin e tyre socio-ekonomik, gjininë, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, përkatësinë fetare ose mënyrën e jetesës. Prandaj, është me rëndësi që çdo person i lidhur me ALG-në të kuptojë abuzimin e fëmijëve, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e tij ose të saj në mbrojtjen e fëmijëve.

Çdo përkufizim i abuzimit të fëmijëve kërkon fillimisht një përkufizim të fëmijës. Sipas KDF-së, fëmijë është "çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç nëse ligji kombëtar e njeh moshën madhore më herët".

Abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve ndodh në të gjitha vendet dhe shoqëritë. Përpjekja për ta përcaktuar ose kuptuar mund të jetë e vështirë për shkak të dallimeve të mëdha kulturore, fetare, sociale, politike, ligjore dhe ekonomike që përjetojnë fëmijët. Për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj abuzimit të fëmijëve, është e rëndësishme që ALG-ja si organizatë të arrijë një mirëkuptim të përbashkët se çfarë është keqpërdorimi i fëmijëve dhe në cilat rrethana zbatohen politikat dhe procedurat tona. Për më tepër, ALG-ja është e angazhuar që të zgjerojë rritjen e ndërgjegjësimit, parandalimin dhe punën e ndërmjetësimit brenda familjeve dhe palëve të tjera të interesit.

Një abuzues shpesh është një person i afërt me fëmijën dhe të cilit fëmija i beson. Nëpërmjet kësaj politike ne duam të ndikojmë pozitivisht në praktikat e familjeve dhe komunitetit. Për më tepër ALG-ja e njej rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve, duke fuqizuar vajzat dhe djemtë që të flasin kundër të gjitha formave të abuzimit, duke vepruar si agjentë të vetë-mbrojtjes dhe mbrojtjes së bashkëmoshatarëve të tyre.

3. Qëllimet dhe synimet e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve

3.1 Përkufizimi i Mbrojtjes

"Mbrojtja e Fëmijëve është përgjegjësi që organizatat kanë për të siguruar që stafi, operimet dhe programet e tyre të mos dëmtojnë fëmijët, kjo do të thotë të mos i ekspozojnë fëmijët ndaj rrezikut, dëmit dhe abuzimit dhe se çdo shqetësim që organizata ka rreth sigurisë së fëmijëve brenda komuniteteve në të cilat ata veprojnë, raportohet tek autoritetet e duhura"

Qëllimi i politikës dhe i procedurave është që të rregullohet mënyra se si ne punojmë si organizatë në mënyrë që fëmijët me të cilët jemi në kontakt (direkt ose tërthorazi) të mbrohen dhe të promovohet mirëqenia e tyre dhe që veprimet tona, gjatë zbatimit të programeve ose aktiviteteve institucionale, nuk shkaktojnë ndonjë dëm tek fëmijët.

3.2 Synimi i politikës

Synimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve është:

1. Parandalimi i rasteve të abuzimit të fëmijëve dhe zvogëlimi i numrit të incidenteve (fëmijë-fëmijë, i rritur-fëmijë) në mjedisin dhe programet e ALG-së;
2. Vetëdijësimi i fëmijëve për të drejtat dhe detyrat e tyre dhe rolin e tyre aktiv në mbrojtjen e fëmijëve të tjerë;
3. Informimi i fëmijëve, të punësuarëve, anëtarëve të bordit, anëtarëve të familjes dhe komunitetit, vullnetarëve dhe partnerëve (donatorë, gazetarë, autoritete qeveritare, OJQ të tjera etj.) rreth politikës së mbrojtjes së fëmijëve dhe procedurave përkatëse (ndërgjegjësimi, parandalimi, raportimi, reagimi);
4. Inkurajimi i stafit që është i përfshirë drejtpërdrejt në punën me fëmijët për të aplikuar aftësitë e nevojshme për të kontribuar në zhvillimin dhe mbrojtjen e secilit fëmijë që është pjesë e komunitetit të ALG-së;
5. Sigurimi që të gjithë të punësuarit të kenë kushtet e punës të nevojshme për të kontribuar në zhvillimin dhe mbrojtjen e secilit fëmijë brenda komunitetit të ALG;

6. Nxitja e diskutimeve të hapura dhe të sinqerta mbi abuzimin e fëmijëve në takimet dhe punëtoritë e organizuar nga ALG dhe ato kombëtare në të gjitha programet dhe lehtësirat ndërmjet të gjithë grupeve të interesit (fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre, stafi drejtues, anëtarët e bordit, konviktet dhe stafi i kuzhinës, trajnerët, mirëmbajtja dhe personeli tjetër etj.);
7. Vendosja e kanaleve raportuese të drejta, të sigurt dhe transparente në të gjitha llojet e programeve që garantojnë të drejtën e palëve (fëmijëve, prindërve, stafit) për t'u dëgjuar;
8. Formimi i një rrjeti aktiv të mbrojtjes në mënyrë që të gjithë fëmijët dhe të rriturit në organizatën tonë të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur. Bashkëpunëtorët të përpiqen së bashku për mbrojtjen e fëmijëve brenda dhe jashtë gjithë programeve.

4. Çfarë është abuzimi i fëmijëve? – përkufizimet dhe terminologjia

4.1 Nga rrjedh abuzimi i fëmijëve?

Abuzimi i fëmijëve ka rrënjët e tij shumë herët në kontaktet mes njerëzëve. Ai fillon me shkeljen e hapësirës personale të të tjerëve pa arsye të fortë transparente që mund të bëhet me dashje ose pa dashje. Shkelja e qëllimshme e hapësirës së tjetrit mund të përfundojë në forma të ndryshme abuzimi.

4.2 Përkufizimet e katër llojeve kryesore të abuzimit të fëmijëve

4.2.1 Abuzimi fizik

Nënkupton dëmtimin aktual ose potencial të shkaktuar nga një veprim apo mosveprim, i cili arsyeshëm është brenda kontrollit të prindit ose të personit në një pozitë përgjegjësie, fuqie ose besimi. Abuzimi fizik mund të përfshijë goditjen, shuplakën, shkundjen, gjuajtjen, helmimin, djegjen ose përvëlimin, mbytjen nga uji ose mbytjen nga asfiksia. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë dëmin fizik ndaj një fëmije duke i sajuar ose duke i shkaktuar qëllimisht simptoma të shëndetit të lig të një fëmijë. Incidentet mund të jenë të vetme ose të përsëritura.

4.2.2 Abuzimi seksual

Është një aktivitet ndërmjet një fëmije dhe një të rrituri ose një fëmije tjetër, i cili, sipas moshës ose zhvillimit, është në një pozitë përgjegjësie, besimi ose fuqie; aktivitet që ka për qëllim të kënaq ose plotëson nevojat e personit tjetër.

4.2.3 Neglizhimi

Është mosveprimi me ose pa dashje i kujdestarit për të siguruar zhvillimin e fëmijës në: shëndetësi, arsim, zhvillim emocional, ushqim, strehim dhe kushte të sigurt jetese, në kontekstin e burimeve të ciat janë arsyeshëm në dispozicion të familjes ose kujdestarëve dhe që shkakton, ose ka probabilitet të lartë të shkaktojë, dëm në shëndetin e fëmijës ose zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror. Kjo përfshin dështimin për të mbikqyrur siç duhet dhe për të mbrojtur fëmijët nga dëmi sa më shumë që është e mundur.

4.2.4 Abuzimi emocional

Ka të bëjë me keqtrajtimin e vazhdueshëm emocional të një fëmije që ndikon negativisht në vet-vlerësimin dhe zhvillimin e tij/saj. Kjo mund të përfshijë përcjelljen e mesazhit tek fëmija se ai ose ajo është i pavlerë, i padashur dhe i papërshtatshëm, ose është aty vetëm për të përmbushur nevojat e një personi tjetër, ose imponimin e pritjeve të papërshtatshme nga ai/ajo. Veprat përfshijnë kufizimin e lëvizjes, kërcënimin, frikësimin, diskriminimin, dhunën, korruptimin, përqeshjen, degradimin, ngacmimin, poshtërimin (p.sh. duke kërkuar pyetje apo veprime potencialisht të turpshme) ose forma të tjera jo-fizike të trajtimit armiqësor ose refuzues. Abuzimi emocional gjithashtu mund të definohet si shfrytëzimi i ndjeshmërisë emocionale të fëmijëve për nevojat emocionale të atyre të përfshirë në punën me fëmijë.

4.2.5. Abuzimi kibernetik

Përfshin ngacmimin dhe frikësimin, publikimin e gënjeshtreve dhe forma të tjera të dhunës. Kjo dhunë përfshin përjashtimin ose izolimin në internet, vjedhjen e identitetit, vjedhjen e fjalëkalimit ose prezantimin e rrejshëm, video inçizimin, sekstingun ose shfaqjen e përmbajtjes eksplicite seksuale.

4.3 Konsideratat specifike

4.3.1 Abuzimi fëmijë-fëmijë

Akuzave ose shqetësimeve lidhur me abuzimin e një fëmije nga një fëmijë tjetër duhet t'u përgjigjemi me ndjeshmëri të veçantë; Edhe ata duhet të trajtohen përmes procedurave të mbrojtjes së fëmijëve. Të gjitha punët me të rinjtë që kanë kryer abuzime kërkojnë një qasje efektive e cila siguron ruajtjen e njerëzve të prekur, ndërsa në të njëjtën kohë mbështet të riun në sfidimin dhe ndryshimin e sjelljes së tij / saj. Çdo qasje e tillë kërkon:

- Pranimi se një fëmijë që ka abuzuar me një fëmijë tjetër dallon në mënyrë të konsiderueshme nga të rriturit që kanë kryer vepra të ngjashme, pasi që fëmija nuk është plotësisht në dijeni se pse ai ose ajo ka kryer abuzime dhe cilat janë pasojat;

- Marrja parasysh e interesit më të mirë të fëmijës është konsiderata kryesore në të gjitha vendimet e marra - edhe për viktimat edhe për abuzuesit.

4.3.2 Deklarimet e historive të abuzimit

Termi histori e abuzimit në këtë politikë i referohet abuzimit që të rriturit raportojnë se kanë vuajtur si fëmijë ose të rinjë përderisa kanë qenë në kontakt me ALG-në. Shpesh ndodh që një individ nuk raporton abuzimin derisa të kenë kaluar shumë vite pas ngjarjes.

Çdo deklaram i tillë ngrihet si shqetësim për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet procedurave të mbrojtjes së fëmijëve. ALG-ja është e përgatitur për të trajtuar deklaratat e historive të abuzimit në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme sipas procedurave të përcaktuara për menaxhimin e krizave.

Ne do të:

- Dëgjojmë deklaratat e historive të abuzimit, do t'i marrim ato seriozisht dhe të veprojmë me përgjegjësi ndaj tyre;
- Kërkojmë të promovojmë mirëqenien e atyre të rriturve që deklarojnë histori të abuzimit;
- Mbrojmë çdo fëmijë që aktualisht është nën kujdesin tonë nga personi që pretendohet të jetë abuzuesi.

4.4 Shkelja e privatësisë së fëmijëve

- Mbrojtja e privatësisë së fëmijës i referohet të dhënave private të fëmijës, si fotografive, teksteve, filmave e të tjera, të fëmijëve, të cilat përdoren për qëllime publiciteti apo private.
- Çdo informacion rreth historisë së fëmijës, gjendjes shëndetësore dhe prejardhjes familjare duhet të ruhet me kujdes në administratën e ALG-së (degët përkatëse). Këto të dhëna duhet të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe me diskrecion dhe në asnjë mënyrë të publikohen pa dakordimin e kujdestarit ligjor të fëmijës.
- Fëmijët dhe prindërit ose kujdestarët e tyre mund të mos jenë gjithmonë në dijeni për një formë të veçantë abuzimi emocional që mund të ndodhë në mbledhjen e fondeve, marrëdhënieve publike ose komunikimit. Për shembull, privatësia e një fëmije shkelet nga prodhimi i paautorizuar i materialeve publicitare (fotografi, filma, tekste) ku shfaqet djali ose vajza; ose paraqitjen e informacionit të ndjeshëm brenda një konteksti që zbulon identitetin e fëmijës.
- ALG-ja "respekton të drejtën e fëmijës për privatësi". Të gjithë të punësuarit dhe partnerët e jashtëm të përfshirë në përhapjen e informacionit mbi fëmijët dhe në krijimin dhe shpërndarjen e materialeve publicitare duhet të veprojnë sipas udhëzimeve të mëposhtme.

- Gjatë përgatitjes së materialit publicitar që paraqet një fëmijë, kërkojmë leje edhe nga fëmija edhe nga përfaqësuesi ligjor (ose së paku një kujdestar të rritur të fëmijës);
- Ne nuk kërkojmë në mënyrë aktive nga fëmijët që të bëjnë ose të thonë ndonjë gjë që mund t'i bëjë ata të ndjehen të shfaqur si "objekte keqardhjeje" (p.sh. për të kërkuar donacione).
- Ne trajtojmë me kujdes emrat e fëmijëve, veçanërisht në lidhje me informacionin e ndjeshëm për të njëjtit fëmijë (p.sh. familjen, sfondin, gjendjen e tyre mjekësore, aftësinë e kufizuar ose sjelljen negative);
- Ne veprojmë me kujdes kur bëhet fjalë për kombinimin e informacionit tekstual dhe vizual, sa herë që një tekst përmban informata të ndjeshme për një fëmijë dhe kur një fotografi ose një video tregon aspekte të ndjeshme të jetës së fëmijës dhe zbulon identitetin e tij / saj.
- Përmbajtja e këtyre udhëzimeve siguron respektimin e privatësisë së fëmijëve, ndërkohë që parandalon dhe rrit ndërgjegjësimin për shkeljet e kësaj privatësie. Në bazë të këtyre udhëzimeve, të punësuarit që janë të përfshirë drejtpërdrejtë me fëmijët kanë të drejtë dhe detyrim për të mbrojtur fëmijët nga çdo përpjekje për shkeljen e privatësisë së tyre - qofshin ato të qëllimshme apo jo.
- Ne do të përcjellim të njëjtat kushte tek palët e tjera që kërkojnë ndihmën tonë ose lejen për hulumtim, filmim, regjistrim, fotografim ose dokumentim në shkollat tona ose situata të tjera ku jemi të përfshirë. Duke njohur rëndësinë e hulumtimit dhe punës dokumentare në ndryshimin e qëndrimeve publike, duke ndikuar në politika dhe duke siguruar burime për ndryshim, ne pranojmë se ka arsye të vlefshme për të kërkuar një leje të tillë siç është cekur më sipër dhe për t'u angazhuar në të dhe prandaj jemi të përkushtuar që të respektohen kushtet për një punë të pritshme në këtë sektor.

5. Palët e interesit

Mbrojtja e fëmijëve është në interesin e të gjithëve. Është pjesë e integruar e punës sonë dhe prek të gjithë në ALG dhe këdo që vjen në kontakt me organizatën tonë.

5.1 Mesazhet kyçe për palët e interesuara:

Fëmijët (nën 18 vjeç) dhe *Vullnetarët* (nxënësit e shkollave të mesme që punojnë në ambientet tona)

- Ju keni të drejta - dhe kjo përfshin të drejtën për të thënë 'JO';
- Dhuna nuk lejohet;
- Ne ju dëgjojmë dhe ju marrim seriozisht.



Ish nxënësit e ALG-së:

- Edhe ju jeni një palë e përfshirë në ALG;
- Ne ju dëgjojmë dhe ju marrim seriozisht;
- Mbështetni komunitetin tuaj: bëni edhe ata të vetëdijshëm për të drejtat e tyre.

Profesorët, Vullnetarët, Stafi teknik, Bordi dhe Administrata (njerëzit që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët):

- Ju nuk jeni i vetmi që brengoset për abuzimin fëmijë-fëmijë;
- Ju jeni model dhe dëgjoheni;
- Dëgjoni fëmijët: Kushtojini vëmendje shenjave të mundshme të abuzimit; merrni përgjegjësinë tuaj dhe qëndroni aty kur ata kanë nevojë për mbështetjen tuaj;
- Nëse nuk mundeni vetë atëherë kërkoni ndihmë ose dërgoni fëmijën tek dikush që mund ta ndihmojë.

Administrata, mirëmbajtja dhe kuzhina e ALG-së:

- Ju luani një rol të rëndësishëm në sigurimin e përfshirjes së të gjitha palëve të interesit dhe respektimit të mendimit të fëmijëve;
- Ju keni të drejtë të favorizoni mirëqenien e fëmijës mbi informacione ose për nevoja për mbledhjen e fondeve.

Familjet e fëmijëve:

- Ju keni mbështetje e shkollës nëse dyshoni ne abuzim.

Vizitorët

- Shkolla ka një menaxhim që siguron mbrojtjen e fëmijëve në hapësirat e shkollës.

6. Implikimet për organizatën: Ajo që ne bëjmë - pjesët kyçe të kësaj politike

VETËDIJËSIMI: Rritja e vetëdijes për abuzimin e fëmijëve dhe rreziqet e tij;

PARANDALIMI: Dhënia e udhëzimeve se si t'i ruajmë fëmijët nga abuzimi dhe si të ruhen ata vetë;

RAPORTIMI: Ngritja dhe respektimi i një procedure të qartë dhe të thjeshtë të raportimit;

REAGIMI: Sigurimi që të ndërmerren veprime të qarta kur abuzimi i fëmijëve dyshohet ose raportohet.

6.1 Vetëdijësimi

Zhvillimi i një kulture të hapur dhe të përgjegjshme në të gjitha programet e ALG-së dhe brenda komuniteteve ku jemi aktiv është thelbësore për mbrojtjen e fëmijëve. Ne si organizatë dhe si bashkëpunëtorë individualë duhet të kemi guxim për të thyer heshtjen dhe tabutë rreth diskutimit të abuzimit me fëmijët. Përmes komunikimit të mbrojtur, të qartë dhe të ndershëm, ne japim dhe marrim reagime pozitive dhe kritike.

Është shumë e rëndësishme të vëzhgojmë konsideratat themelore vijuese:

1. Të gjithë personat e lidhur me ALG-në duhet të kuptojnë abuzimin e fëmijëve dhe të gjitha pasojat e tij.
2. Ne duhet të sigurojmë mundësi të rregullta për të diskutuar të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre (për shembull në takime apo diskutime joformale me të prekurit).
3. Ne ofrojmë mundësi të rregullta për vajzat dhe djemtë (të moshave dhe prejardhjeve të ndryshme) për të shprehur shqetësimet e tyre, në mënyrë që të mund të dëgjohen dhe adresohen të gjitha shqetësimet rreth mbrojtjes së tyre.
4. Zhvillimet e shëndosha të fëmijëve të jenë udhërrëfyese të procesit tone të mbrojtjes së fëmijëve. Në rastet e konflikteve të interesit, ne i japim përparësi mirëqenies së fëmijës.
5. Rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve përcaktohen dhe komunikohen qysh në fillim.
6. Të gjitha kontratat e punës dhe kodet e sjelljes të nënshkruara nga të punësuarit dhe përfaqësuesit e organizatës gjithashtu i referohen Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës.
7. Të gjithë punonjësit që kanë kontakt direkt apo tërthorazi me fëmijët në Loyola-Gymnasium marrin pjesë në trajnimin për Implementimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve.
8. Fëmijëve të komunitetit ALG i bëhet e ditur Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve duke i vetëdijësuar ata lidhur me llojet e abuzimeve dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në rast të dyshimit për abuzim.

6.2 Parandalimi

Për të parandaluar abuzimin e fëmijëve ne duhet të krijojmë dhe të mbajmë një mjedis që promovon vlerat themelore të ALG-së në shkollat dhe në aktivitetet dhe programet e tjera të ALG-së.

Një gamë e gjerë veprimesh mund të ofrojnë mbështetje ashtu që fokusi kryesor të jetë në zbatimin e qasjeve të përshtatshme të rekrutimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit. E kombinuar me këtë, është e domosdoshme që të dëgjojmë me kujdes fëmijët, t'i marrim seriozisht pikëpamjet e tyre, t'i inkurajojmë ata të marrin pjesë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe t'u ofrojmë atyre mundësinë për të ndërtuar marrëdhënie të mbushura me besim. Është e qartë se abuzimi i fëmijëve ka më pak

gjasa të ndodhë brenda një konteksti që nxit pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha nivelet përveç në ato mjedise ku ata nuk janë të aftë ose dëmtohen.

1. Standardet më të larta zbatohen gjatë procedurave të përzgjedhjes, rekrutimit dhe verifikimit të bashkëpunëtorëve të rinjë. Aplikantët për çdo pozitë, qoftë punësim ose punë vullnetare, duhet të raportojnë çfarëdo dosje penale të mëparshme. Kjo arrihet përmes sigurimit të një dëshmie nga policia dhe kontrollit të tërthortë të referencave.
2. Të gjithë të punësuarit marrin trajnim adekuat dhe nënshkruajnë kodin e sjelljes që konfirmon se kuptojnë dhe do të angazhohen për politikën tonë të mbrojtjes së fëmijëve.
3. Të gjithë të punësuarve u ofrohet orientim në lidhje me politikën e mbrojtjes së fëmijës gjatë muajit të tyre të parë të punësimit.
4. Mbrojtja e fëmijëve është një temë e rregulltë në të gjitha programet e trajnimit.
5. Nëpërmjet trajnimit dhe shkëmbimit të përvojave, ne mësojmë dallimin në mes të sjelljes së përshtatshme dhe të papërshtatshme. Stafit i ALG-së dhe vullnetarët i trajtojnë fëmijët me dashuri, por mbajnë kufijtë e qartë dhe mbështetës.
6. Fëmijëve u mundësohet marrja e roleve në zhvillimin dhe ruajtjen e tyre. Ata inkurajohen të marrin pjesë në të gjitha çështjet që ndikojnë në jetën e tyre dhe të përfshihen në diskutimet mbi të drejtat e tyre. Fëmijët diskutojnë se çfarë është sjellja e pranueshme dhe e papranueshme dhe çfarë mund të bëjnë nëse ndiejnë se diçka nuk është e drejtë.
7. Secilit fëmijë i ofrohet mundësi individuale për zhvillim të përshtatur për nevojat dhe potencialin e tij / saj. Të punësuarit marrin trajnim dhe mbështetje për të vënë aktivitetet e zhvillimit të fëmijës në veprim.
8. Të gjithë fëmijët dhe kolegët kanë qasje në shërbimet e këshillimit nëse është e nevojshme.
9. Bashkëpunëtorët inkurajohen të ndajnë rregullisht përvojat brenda dhe ndërmjet programeve në lidhje me mënyrën se si ata i drejtohen mbrojtjes së fëmijëve.
10. Ne mbështesim ngritjen e vetëdijes dhe ndërtimin e kapaciteteve të prindërve dhe udhëheqësve të komunitetit në disiplinë pozitive, si alternativa kundër ndëshkimit trupor.

6.3 Raportimi

Ne marrim të gjitha shqetësimet e ngritura seriozisht dhe ndërmarrim masat e duhura. Çdo projekt që punon me fëmijët përcakton dhe zbaton procedura të qarta të raportimit dhe reagimit, duke përfshirë linjat e brendshme të komunikimit, dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë të përfshirëve. Merren masa të shpejta dhe transparente që marrin parasysh përgjegjësitë ligjore.

6.3.1 Kush duhet të raportojë?

Çdo person i komunitetit të ALG-së që në mënyrë direkte apo tërthorazi vëren apo dyshon për abuzim duhet të raportojë.

6.3.2 Kujt mund t'i raportoje?

Çdo person ndjen një mbështetje më të madhe tek persona të caktuar. Varësisht nga ajo se me kë ndjehen më të lirë, raportimet mund t'i drejtohen cilitdo anëtar të stafit të ALG-së:

- Mësimdhënësit të lëndës, kujdestarit të klasës, Parlamentit të Nxënësve, Profesorëve të besueshëm të zgjedhur nga Parlamenti i Nxënësve, Përfaqësuesve të Këshillit të Profesorëve, Këshillit të Prindërve, Kryesuesve të Aktiveve Profesionale, këshilltarit personal, punonjësve të administratës, punonjësve të mirëmbajtjes, atyre të kuzhinës apo drejtpërdrejtë udhëheqjes. -

Duke i mbajtur kanalet e raportimit të gjëra dhe të gjithë si person përgjegjës, ne besojmë që abuzimet e mundshme mund të parandalohen dhe mund të veprohet më shpejtë.




Fig. 1 Skema e raportimit

6.3.3 Pika Fokale

Nën kulmin e ALG-së ekzistojnë pikat fokale ku mund të pranohen dhe trajtohen të gjitha raportimet e abuzimeve.

Pika fokale është një person i propozuar nga drejtori ekzekutiv dhe i konfirmuar nga bordi. Ai / ajo ka një mandat prej 2 vjetësh me të drejtë vazhdimi por jo më shumë se 6 vjet.

Pika fokale mbështetet nga dy persona të tjerë neutral, të cilët e propozohen nga vet ai / ajo dhe konfirmohen nga drejtori ekzekutiv. Asistentët kanë mandat të njëjtë (2 vjet me të drejtë vazhdimi por jo më shumë se 6 vjet).

Në rast se dyshohet në abuzim nga pika fokale atëherë incidenti kalon nën përgjegjësinë e asistentëve dhe raportohet tek ata / ato.

6.4 Reagimi

Të gjitha format e abuzimit të fëmijëve merren seriozisht, pa përjashtim dhe në të gjitha projektet e ALG-së, dhe reagohet përshtatshëm me rëndësinë e shkeljes së supozuar. Ne sigurohemi që gjithmonë të ketë një reagim, pavarësisht nëse llojit të abuzimit. Duke reaguar ne garantojmë që do të ndiqet një procedurë transparente dhe e drejtë, kështu që askush të mos dënohet gabimisht dhe që drejtat e të gjithë personave të përfshirë të mbrohen.

1. Në shkollë do të ketë një pikë fokale ku të gjitha incidentet e raportuara do të komunikohen dhe do të vendosen për veprime të mëtejshme nëse është e nevojshme.
2. Konfidencialiteti është me rëndësi të madhe kur merret me rastet e abuzimit; Informacioni trajtohet me ndjeshmëri. Fëmija ose çdo person tjetër i cili jep informata lidhur me abuzimin njoftohet dhe sigurohet se nëse ai ose ajo e raporton rastin, informacioni mbi abuzimin e raportuar do të ndahet vetëm me personat e autorizuar për të pasur qasje në këtë informacion, dmth. pika fokale dhe personat e tjerë të përfshirë.
3. Në të gjitha rastet e abuzimit ose neglizhencës së dyshuar ose të provuar të fëmijëve, fokusi përqendrohet në ruajtjen dhe mbrojtjen e fëmijës. Në të njëjtën kohë, sigurohen masat rikuperuese dhe garantohet mbrojtja e të gjithë personave të përfshirë.
4. ALG-ja përcakton procedurat që duhen ndjekur për nivele të ndryshme abuzimi. Në hetimin e rastit të abuzimit të fëmijëve mund të kërkohet ndihma e jashtme.
5. Në të gjitha rastet e abuzimit, një hetim i brendshëm kryhet nga pika fokale ose asistentët e tij/saj, i cili merr një vendim për hapat e mëtejshëm.
6. Çdo i punësuar është i detyruar të japë menjëherë ndonjë informacion që ai ose ajo ka lidhur me rastet e mundshme të abuzimit të fëmijës përkatës. Çdo i rritur që mban informacion ose mbulon çdo lloj abuzimi konsiderohet bashkëfajtor.



7. Fëmijët, bashkëpunëtorët ose të rriturit e tjerë që raportojnë mbrohen dhe mbështeten.
8. Personi i akuzuar njoftohet për fillimin e hetimit kundrejt tij/saj dhe ndërmerren masa për mbrojtjen e reputacionit të tij/saj derisa hetimet vazhdojnë.
9. Personit të akuzuar për abuzimin e fëmijëve i mundësohet seancë e drejtë dëgjimore.
10. Në raste të dyshimit për abuzimi serioz seksual, i akuzuari suspendohet menjëherë (pa humbur benefitet) deri në përfundim të hetimeve.
11. Reagimi ndaj abuzimit fëmijë-fëmijë përqendrohet në atë që është më e mira për zhvillimin dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve të përfshirë në këtë rast.
12. Nëse supozohet se abuzimi është kryer nga një i rritur, varësisht nga niveli i abuzimit, ndërmerren hapa ligjor në përputhje me raportimin dhe reagimin kombëtar që përcakton nivelin e reagimit për secilin rast individual. Kur është e nevojshme, do të kërkohet asistencë ligjore.
13. Nëse supozohet se abuzimi është kryer nga pika fokale, ai / ajo do të përjashtohet nga trajtimi i incidentit dhe përgjegjësia i kalon asistentëve.
14. Trajtimi i informacionit dhe komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm në lidhje me incidentet e abuzimit të fëmijëve brenda ALG-së është nën përgjegjësinë e drejtorit ekzekutiv ose një personi të caktuar nga ai.
15. Vendimet dhe veprimet merren pa humbur kohë cilësore.
16. Përgatitet raport për incidentin dhe i raportohet drejtorit/eshës të institucionit përkatës.
17. Nëse dyshohet se abuzimi është kryer nga drejtori/eshja e shkollës atëherë i raportohet drejtorit ekzekutiv.
18. Rastet e rënda raportohen tek autoritetet e mirëqenies së fëmijëve sipas kërkesave ligjore dhe një procedure të përcaktuar nga ALG-ja.
19. Të dhënat e shkruara për të gjitha rastet e abuzimeve të raportuara dhe konkluzionet e tyre mbahen në mënyrë strikte konfidencialisht në shkollë.




Fig. 2 Hapat e reagimit

7. Vlerësimi i riskut

7.1 Infrastruktura

Ne i përkushtohemi ofrimit të një ambienti të sigurtë dhe të përshtatshëm për të gjithë nxënësit dhe punonjësit tanë.

Ne jemi të vetëdijshëm që siguria individuale fillon me gjendjen e ndërtesës dhe oborrit. Kjo përfshin gjendjen e jashtme dhe të brendshme gjatë tërë kohës, si dritat, rrymën elektrike, sigurinë e të dhënave, privatësinë, higjienën, mbrojtjen nga zjarri, trafikun, etj.

Reagimi ndaj ankesave dhe vërejtjeve është i menjëhershëm dhe i besueshëm, gjithmon duke u përpjekur për të garantuar një ambient sa më të sigurtë.

Çdo 3 vjet organizohet një vlerësim serioz dhe sistematik i rrezikut në të gjithë hapësirën shkollore.

Është përgjegjësi e secilit person pjesë e komunitetit ALG të vërejë dhe të informojë udhëheqësinë për rreziqet e mundshme të shkaktuara nga infrastruktura.

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për kontrollim sistematik dhe të rregullt të hapësirës.

7.2 Reflektimi

Ne e shohim shkollën si një organizëm të gjallë që vazhdimisht përjeton ndryshime. Ndryshimet mund të vijnë pa ndonjë arsye dhe pa u vërejtur por mund të vijnë edhe nga udhëheqësia apo përfaqësuesit e saj.

Ne komunikojmë me kujdes dhe shprehim kritikën apo japim propozime pas shumë reflektimeve. Detyrat kryhen me veprime të menduar.

Metodat dhe mënyrat e reja, përvojat, ndryshimet dhe inovacionet janë të mirëseardhura nëse janë të përgatitura me kujdes, të implementuara me transparencë dhe reflektuar e vlerësuar hapur me të gjithë pjesëmarrësit.

Të gjitha inovacionet organizative dhe kurrikulare rishikohen dhe vlerësohen nga udhëheqja e shkollës para se të merret vendimi për implementimin e tyre në afat të gjatë kohor.

Nxënësit kanë të drejtën të zbulojnë kuptimin dhe mundësinë e reflektimit të përvojave të tashme për sfidat e ardhshme.

7.3 Kujdesi individual

Krijimi i marrëdhënieve konstruktive profesionale në mes kolegësh dhe me anëtarë të familjeve të fëmijëve është hapi kyç për mirëfunksionimin dhe parandalimin apo edhe trajtimin e keqtrajtimeve të fëmijëve.

Ne nuk nisemi nga parimi se e dimë çfarë ka ndodh apo çfarë do të ndodh dhe përpiqemi të jemi kritik ndaj vetes prandaj edhe pranojmë kur jemi gabim.

ALG i qaset riskut me një kornizë gjithpërfshirëse që:

- shqyrton rrezikun dhe dëmin duke bërë kërkime në fuqitë dhe sigurinë e tij;
- vë në pah njohurinë profesionale të artikuluar në mënyrë të qartë duke nxjerrë në pah edhe njohurinë dhe dijen familjare;
- përfshin të gjithë palët, nga profesionistët tek familjarët.

Ne projektojmë një protokol vlerësimi të riskut dhe planifikimit që harton dëmin, rrezikun, faktorët e komplikimit, fuqitë, siguria e kërkuar dhe ajo ekzistuese dhe një gjykim sigurie në situatat ku fëmijët janë të brishtë ose të keqtrajtuar. Protokoli i vlerësimit dhe planifikimit si dhe proceset e pyetjeve dhe kërkimeve që e mbështesin atë, janë të dizajnuar të jenë harta organizes për ndërhyrjen për mbrojtjen e fëmijëve që nga fillimi deri në përmbyllje të rastit. Kjo strukturë përmban 3 fusha për hetim:

- Për çfarë shqetësohemi? (dëmi në të kaluarën, rreziku në të ardhmen dhe faktorët e komplikimit)
- Çfarë po funksionon mirë? (fuqitë dhe siguria ekzistuese)
- Çfarë duhet bërë? (siguria në të ardhmen)

Për çfarë shqetësohemi?	Çfarë po funksionon mirë?	Çfarë duhet bërë?

8. Dispozita të tjera

Kjo politikë do të plotësohet në vazhdimësi në bazë të nevojave të kohës.

Ajo do të rishqyrtohet tërësisht çdo 3 vjet.

Përgjegjësia për përditësim dhe publikim qëndron tek drejtori ekzekutiv.